



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/198 Nr. i faq./Br.str./No.pg 63

Data/Datum/Date 29/02/2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

JEPET PËLQIMI paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik dhe juridik deri në 25 (njëzet e pesë) vite, për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, respektivisht vendosjen e paneleve solare, përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2

Pronat e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim, sipas nenit 1 të këtij vendimi janë:

1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02302-1 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur ravne shume, me kulturë Kullosë e klasës 5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 162513m² (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e trembëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02299-0 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur grot, me kulturë Arë e klasës 7, në sipërfaqe të përgjithshme prej 6806 m² (gjashtëmijë e tetëqind e gjashtë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

Neni 3

Çmimi fillestar i pronave komunale të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të jetë 1.5cent/m² në muaj (një pikë zero pesë cent për metër katror), në shumën e përgjithshme prej 2,539.78€ (dymijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e tetë cent) në muaj. Realizimi i pagesës në qira fillon pas 36 muajve.

Neni 4

OBLIGOHET Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur përmes shprehjes së interesit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në

Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.198/24
Me datë:29.02.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit

